

Banka Për Biznes, Zyra Qendrore shpall konkurs për pozitën:

KONKURS

Menaxher/e i/e Sektorit të Raportimit në Departamentin e Financave

Kualifikimet:

- Kualifikim universitar në Ekonomi, Financa apo të ngjashme – SCAAK apo një kualifikim i ngjashëm është një përparësi;
- Së paku 5 vite përvojë pune në fushën e raportimit financiar, preferohet përvojë pune në sektorin bankar;
- Njohuri të dëshmuara në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar;
- Aftësi të shkëlqyeshme analitike;
- I/e aftë të punojë në ekip si dhe në mënyrë të pavarur;
- Aftësi për menaxhimin e stafit në kuadër të sektorit;
- Nivel i avancuar i Gjuhës Angleze;
- Nivel i avancuar i përdorimit të MS Office si Excel, Power Point, etj.

Përgjegjësitë:

- Përgatitja dhe publikimi i raporteve mujore, kuartale dhe vjetore për Bankën Qendrore të Kosovës;
- Përgatitja e raporteve mujore financiare për Menaxhmentin e Bankës;
- Përgatitja e pasqyrave vjetore financiare sipas IFRS dhe BQK-së të gatshme për auditim;
- Barazimi i kontove sintetike me ato analitike në mes të librit kryesor dhe moduleve përkatëse;
- Koordinimin e procesit të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm;
- Të sigurojë pajtueshmëri të plotë me kërkesat raportuese ligjore dhe ato rregullative;
- Komunikon dhe shpjegon çështjet ligjore, rregullative dhe udhëzimet e ligjeve të kontabilitetit dhe të standardeve të aplikueshme të raportimit financiar;
- Përgatitja dhe monitorimi i procedurave që lidhen me sektorin e raportimit financiar.

Procedura e aplikimit:

Ju lutem plotësojeni formularin për aplikim i cili gjendet në: www.bpbbank.com

Afati për aplikim është deri më datë 17 tetor 2018. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë, do të njoftohen për procedura të më tutjeshme.